



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
SPITALI RAJONAL SHKODËR

Nr. 2648/12 prot.

Shkodër, më 13.4.2025

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në përgjigje të kërkesës suaj, të protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 2648 Prot., datë 07.11.2025, lidhur me realizimin e ndërhyrjes kirurgjikale të kataraktit, ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Aktualisht, pranë Klinikës së ORL-OKL në Spitalin Rajonal Shkodër nuk realizohet ndërhyrja kirurgjikale e kataraktit me lente intraokulare, pasi ky shërbim deri më tani është mbuluar vetëm nga një mjek okulist, fakt i cili ka sjellë pamundësi fizike për përmbushjen e të gjitha aktiviteteve që ky shërbim mbulon.

Megjithatë, ju njoftojmë se aktualisht pranë kësaj klinike janë emëruar edhe dy mjekë të tjerë, duke e çuar në tre numrin total të mjekëve okulistë. Pas plotësimit të strukturës me personel mjekësor, Spitali Rajonal Shkodër është angazhuar në marrjen e masave të nevojshme për krijimin e kushteve të duhura për realizimin e kësaj procedure kirurgjikale.

Gjithashtu, në bazë të kërkesës së paraqitur nga Klinika e ORL-OKL-së, ju informojmë se është njoftuar Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për sigurimin e materialeve të nevojshme, konkretisht:

- Facho Emulsification Machine me vitrectom
- OCT (Optical Coherence Tomography)
- Mikroskop operator
- Biometer (Eko A dhe B) për përcaktimin e numrit të lentes intraokulare
- Sete kirurgjikale për ndërhyrje oftalmologjike

Me shkresën me Nr. 2157 Prot. datë 17.09.2025 i jemi drejtuar zyrtarisht FSDKSH-së me kërkesë për marrjen e masave të nevojshme për furnizimin me pajisjet dhe materialet e mësipërme, në mënyrë që ndërhyrjet kirurgjikale të kataraktit të mund të kryhen edhe pranë institucionit tonë, duke zgjeruar kështu gamën e ndërhyrjeve kirurgjikale në shërbim të qytetarëve të qarkut Shkodër.

Duke iu falenderuar për bashkëpunimin,

ZV DREJTOR

Lush MARKU

